




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GLLOGOCIT (DRENASIT)
OPSTINA GLLOGOC- MUNICIPALITY OF GLLOGOC

PROGRAMI KOMUNAL TRE VJEÇAR PËR BANIM 2023-2025



Korrik, 2023

PËRBAJTJA

1 HYRJE.....	5
1.1 QËLLIMI I PROGRAMIT	6
1.2 Vizioni.....	6
1.3 SYNIMI	6
2. KORNIZA LIGJORE	7
2.1 DOKUMENTET TJERA RELEVANTE	7
2.2 STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR	8
3. PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	8
 4. METODOLOGJA PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT	8
 4.1 POZITA GJEOGRAFIKE	9
 4.2 PROFILI I KOMUNËS SË DRENASIT	11
 4.5 KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE POPULLSIA E DRENASIT	12
 4.6 RASTET SOCIALE	14
SHTIMI NATYROR	14
 Sipas raporteve ne DSHMS të komunës së Drenasit numri i lindjeve ka rënëjë të madhe.....	14
 4.7 LËVIZJA E POPULLSISË	14
 4.8 MIGRIMI	15
 4.9 JETËGJATËSIA.....	15
 4.10 ARSIMI	16
 4.11 BANIMI	16
 4.12 KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL.....	18
5. ANALİZË EKONOMIKE.....	19
 5.1 EKONOMIA	19

5.2 BUJQËSIA.....	22
5.3 ZYRA PËR PËRSONAT E RIATDHESUAR	23
5.4 PUNËSIMI	24
5.5 PAPUNËSIA.....	24
BUXHETI I DSHMS (projektet kapitale)	25
6.ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL	26
6.1 OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL	26
6.2 PROGRAMI I BANIMIT	28
6.3 SHFRYTËZUESIT AKTUAL TË BANIMIT SOCIAL.....	28
6.4 KATEGORITË E SYNUARA.....	29
6.5 GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE.....	30
7.PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL.....	32
7.1 SIGURIMI I BANIMIT PËR 4 deri 5 FAMILJE	32
Mënyra e implementimit e skemave për Bonus Banim.....	33
Forma e parë – përzgjedhja direkte e përfituesve;.....	33
Forma e dytë – përzgjedhja e përfituesve me thirrje publike	33
Banimi individual.....	34
8. ZYRTARI PËR BANIM	35
9. PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT	35
10. REZULTATET PAS ZBATIMIT	36
Instrumentet e mbikqyrjes.....	36
Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit te transperencës.....	36
11. ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE	37
11.1 REZULTATET PAS ZBATIMIT	39
11.2 THEMELIMI I SEKTORIT TE BANIMIT	39
12. ANALIZA SWOT.....	40
13. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TREVJEÇAR TE BANIMIT (PËRMBLEDHJE).....	41
13.1 Hapat e ardhshëm.....	42

14. PERFUNDIMI: 42

LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2023-2025

ZYRA E KRYETARIT TE KOMUNËS

VENDIMI 01-Nr .020/04-6514 të datës 02.02.2023

GRUPI PUNUES - KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përjegjësia në Komision
1	Lumturije Kiqina	DSHMS	Kryesues
2	Arlinda Kukaj	DSHMS	Anëtare
3	Besart Bajrami	DPUMM	Anëtar
4	Ahmet Ahmeti	DB	Anëtare
5	Ksamil Ramadani	DZHE	Anëtar

Ky program është realizuar nga

Komisioni Komunal i angazhuar me vendimin e kryetrit të komunës .

1 HYRJE

Programi Trevjeçar i Banimit Social, i adresohet zgjidhjes së çështjes së banimit social në komunën e Drenasit, ngase e drejta e banimit është njëra ndër të drejtat elementare të njeriut që garantonohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (Ligji nr. 03/L – 164) Komunat e Kosovës, e me këtë edhe komuna e Drenasit duhet të merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për sigurim të kulmit mbi kokë për vete dhe për familjet e tyre. Banimi është çështje vendimtare për një stabilitet shoqëror, shëndet të mire dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore. Programi Trevjeçar për banim i komunës së Drenasit i prezantuar në këtë dokument është pasues i programit përvitet 2019-2021 ku janë përbazë të arriturat dhe sfidat gjatë realizimit të programit tashmë të skaduar. Komuna e Drenasit në programet e saj zhvillimore ka përqellim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj, pasi që ka hapësirë përtë përmirësuar jetën e qytetarëve në nevojë përbanim të përkohshëm.

Duk qenë se Komuna e Drenasit kishte të hartuar Programin Trevjeçar për Banim 2019-2021 me vendim të kryetarit të komunës, në të njëjtën formë, kryetari i Komunës së Drenasit ka formuar Komisionin Komunal përhartimin e Programit Trevjeçar përiudhën 2023-2025 pasiqë banimi dhe sigurimi i çështjes së banimit të qytetarëve është obligim i komunës. Pra, komuna e Drenasit duhet të merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për sigurim të banimit kjo është çështje vendimtare për një stabilitet social, shëndet të mire dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore.

Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Nr. 03/L-164, ofrohet një kornizë më e avancuar për autoritetet vendimmarrëse lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Edhe komuna e Drenasit në programet e saj zhvillimore ka përqellim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj, pasi deri me tash, pos investimeve për ndihmë në ndërtim të disa shtëpive, apo riparimeve, nga aspekti i qëndrueshmërisë përbanim social, nuk ka pas ndonjë program te tillë.

Hartimi i Programit përbanim social 2023-2025, do të mundeson kushte përbanim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë vështirë të e bëjnë një gjë të tillë.

Ky dokument, pra Programi Trevjeçar për Banim social, do të mundësojë trajtimin e çështjeve kyçë të identikuara, siç janë mungesa e banimit adekuat, përkeqësimi i banimit ekzistues, etj. Pas këtij programi me punën tone aktive priten të bëhen ndryshime dhe do të krijohet baza ligjore për zgjidhje më të qëndrueshme. Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Komunale Trevjeçare të Banimit bazuar në ligjin Nr. 03/L-164, për financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Dokumenti është hartuar nga grapi punues komunal që ka për qëllim të bëjë përshkrimin e një rrjedhë k r o n o l o g j i k e të banimit nga e kaluara, gjendjen ekzistuese dhe parashikimet e zhvillimit të banimit në vitet në vijim.

1.1 QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi trevjeçar i banimit social në komunën e Drenasit ka për qellim identifikimin e rasteve dhe ndihmën për sigurimin e banimit për kategori të ndryshme të qytetarëve të kësaj komune për zgjidhjen e problemit të banimit. Po ashtu në kuadër të këtij programi parashihet krijimi i një departamenti të veçantë për banim i cili do të trajton çështjen e banimit social dhe të mirëmbajtjes së ndërtesave në bashkëpronësi në mënyrë më efikase.

Ky program po ashtu do të mundëson zhvillimin e politikave adekuate dhe zbatimin e tyre me qellim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për kategori të caktuara të cilat nuk kanë fuqi ekonomike që të zgjidhin problemin e banimit.

Ky dokument është pagatitur në përputhje me Kornizën Ligjore nga fusha e banimit dhe udhëzuesit për hartimin e programeve trevjeçare komunale, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164, për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

1.2 VIZIONI

Përmirësimi i jetës se qytetarëve te komunës së Drenasit dhe sigurimi i banimit për një pjese të qytetarëve është objktivi kryesor, si dhe reduktimi i këtyre familjeve që nuk kanë kulm mbi kokë. Planifikimi dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare për zhvillimin e banimit social dhe përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të jetës të qytetarëve, qe mos të kanë problem të banimit, është dhe do të jetë objektiv primar.

1.3 SYNIMI

Hartimi i këtij programi për banim social do të mundësojë që të konkurrojmë si komunë në ndonjë projekt i cili lidhet me banim social në mënyrë që të krijohen kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standarde normative evropiane të banimit. Pra synimi është që të u mundësohet zgjidhja e

nevojave të kategorive të caktuara të cilat nuk kanë mundësi të zgjidhin problemin e banimit me forca vetanake.

Me hartimin e këtij Programi trevjeçar synojmë plotësimin e obligimeve ligjore, e që hartimi dhe zbatimi i këtyre politikave të banimit në Komunën e Drenasit të ndërlidhet me procesin e integrimit evropian dhe me kriteret për anëtarësim në BE duke respektuar Konventat Evropiane, Kartën Sociale Evropiane dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut.

2. KORNIZA LIGJORE

Programi Tre-Vjeçar për Banim është bazuar në legjislaturën si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit;
 - Ligji Nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi;
 - Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale;
 - Ligji nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
 - Ligji nr.04/L -247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
 - Ligji nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-247;
 - Ligji nr. 05/L – 031 për procedurën e përgjithshme administrative;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2010 për përbajtjen e kontratës për banesën me qira jo profitable;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2010 për përbajtjen e bonusit të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ-nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit,
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ Nr.23/2010 për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit;
 - Udhëzim administrativ- nr. 24/2010 për normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit.

2.1 DOKUMENTET TJERA RELEVANTE

- Statuti i komunës
- Harta zonale 2022 – 2030.

- Plani Zhvillimor Komunal (2020 – 2028)

2.2 STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR

- Strategjia kombëtare për ri integrimin e personave të riatdhesuar, plani i veprimit dhe rregullorja nr. 22/2020 për ri integrimin e personave të riatdhesuar;
- Strategjia kombëtare për ri integrim te qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë 2018-2022;
- Strategjia dhe plani i veprimit përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare - 2022-2026.
- Strategjia per Migrim 2021-2025

3. PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT



Fig.1. Organogrami

4. METODOLOGJIA PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT

Vendimet shtesë për përpilim të Programit Trevjeçar për Banim janë sinë vijim:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit Nr 01-020/04-6514 dt.02.02.2023 për përgatitjen e Projektit të Programit të Veçantë për Banim në Komunën e Drenasit për Periudhën 2023-2025;
- Sigurimi i të dhënavë nga fushat përkatëse të Komunës (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, Qendra për Punë Sociale, Zyra për Komunitete, dhe drejtoritë tjera përkatëse). Për momentin komuna e Drenasit i ka të vendosura disa të dhënat të përfituesve në softuerin e Bazës së të Dhënavë, mirëpo ka nevojë të përmirësohen disa detaje. Kjo duhet të bëhet gjatë implementimit të këtij programi Trevjeçar për banim me ndihmën nga Divizioni për banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dh Infrastrukturës (MMPHI).

- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë bazuar në gjendjen faktike të çështjes së banimit;
 - Struktura e Buxhetit Komunal Drenas;
 - Përgatitja e dokumentit;
 - Bërja publike e Programit Trevjeçar të Banimit) – informimi;
 - Procedurat e miratimit të dokumentit;
 - Aprovimi nga Kuvendi i Komunës;

4.1 POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Drenosit (Gllogocit) eshte themeluar para Luftës se Dytë Botërore si njësi sociale, politike dhe administrative e veçantë. Gjatë tetëdhjet viteve të fundit, zhvillimi ekonomik ka qenë tepër i ultë sepse pushtetet antipopullore të këtyre periudhave kanë ndjekur politikë specifike diskriminuese në çdo sferë të jetës.

Komuna e Drenosit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës me një pozitë shumë të mirë gjeografike – teritor ndërlidhës, gjë që i mundëson kësaj të jetë më afër qendrave tregtare, industriale, qyteteve tjera të Kosovës dhe Kryeqytetit të Prishtinës.

Hekurudha Prishtinë-Fushë Kosovë-Pejë/Prizren, Autostrada Shqipëri-Prizren-Prishtinë-Merdare, pastaj Maxhistralja Arllat-Pejë, Mitrovicë-Skenderaj-Drenas-Komoran dhe Rruga Regionale Komoran-Carralevë, i mundësojnë Komunës së Drenosit qasje ideale me të gjithë koridorët lokal, regional dhe ndërkombëtar duke mos anashkaluar edhe Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” 17 km nga Drenasi që i ofrojnë Drenasit parakushte për zhvillim.

Komuna e Drenosit kufizohet:

- Në jug-lindje kufizohet me teritorin e Komunës së Lipjanit.
- Në Lindje me teritorin e Komunës së Fushë Kosovës dhe Obiliqit.
- Në Veri-Lindje kufizohet me teritorin e Komunës së Vushtrisë,
- Në Veri me teritorin e Skenderajt,
- Në perëndim me teritorin e Komunës së Klinës dhe
- Në Jug-perëndim me teritorin e Komunës së Malishevës.

Zhvillimi i hovshëm i infrastrukturës rrugore dhe konsolidimi i qeverisjes lokale në Komunën e Drenas-sit, i ka dhënë prioritet zhvillimit ekonomik-zhvillimit të sektorit privat, krijimit të

lehtësirave për investime vendore dhe të huaja etj, përmirësimit të mjedisit dhe kushteve të jetesës të banorë-qytetarëve të vet.

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qëndrore të Kosovës, përafërsisht 32 km nga Prishtina, 270 km nga Tirana, 17 km nga Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”

Komuna e Drenasit është një nga dy qendrat më të rëndësishme administrative të cilat shtrihen në rrafshnaltën e Drenicës dhe ka një sipërfaqe prej 275.6 km². Teritori i Komunës së Drenasit gjendet gjithashtu në mes të rrafshit të Kosovës dhe Dukagjinit duke paraqitur një teritor ndërlidhës shumë të rëndësishmëm. Në pjesën Veri-Lindore kemi malin e Qyqavicës me një lartësi mbidetare 1.091 m pastaj majën e Gospojës dhe Goleshit me një lartësi 1.019 m (malet e Blinajës), kurse në Jug-Perëndim gjendjen vargmalet e Drenicës (Berishës) dhe Kosmaqit me një lartësi mbidetare prej 979 m.

Ndërsa Kodi Postar është 13000.




Figura 1. Pozita gjeografike e Drenasit

4.2 PROFILI I KOMUNËS SË DRENASIT

Në vijim janë të prezantuara disa informata bazike lidhur me komunën e Drenasit.

Të dhënat janë marrë kryesisht përveq rregullativës ligjore të cekur më lartë, edhe nga Plani Zhvillimor Komunal 2020 – 2028.

Këto programe perveç tjerash përbajnë:

Nevojat për banim sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre;

Numrin dhe kategorinë e familjeve që do të përfitojnë banesa me qira;

Sigurimin dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë për ndërtimin e banesave, numrin dhe llojin e banesave që nevojitet të ndërtohen, familjet që do të përfitojnë, si dhe formën e bashkëpunimit me sektorin privat.

Për planifikimin e buxhetit për programet e veçanta për banimit merren parasysh këta faktorë: dendësia e popullsisë në nivel të komunave;

- kërkosat e familjeve për nevoja të banimit;
- kategoritë e familjeve të varfëra;
- përparësitë e zhvillimit ekonomik të komunës.

Përgjegjësitet e Komunave

- Identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridikcionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji;
- Hartimin e programeve dhe projekteve tre (3) vjeçare për banim, bazuar në burimet financiare; 1.3. sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit;
- Krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënavë për familjet që përfitojnë nga programet për banim
- Sigurimin e ndërtimit;
- Paraqitjen e kërkosave për financimin e investimeve të reja dhe subvencioneve në Ministri, deri në muajin mars;
- Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave me qira përmes organit kompetent komunal;
- Raportimin vjetor në Ministri deri më 31 mars të vitit vijues për ecurinë e programeve të banimit;
- Varësish nga numri i kerkosave per banim, komuna do e parashek edhe ndertime të reja

4.5 KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE POPULLSIA E DRENASIT

Territori i komunës së Drenasit (ish-Gllogocit) shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore. Lëvizjet demografike në komunën e Drenasit nuk dallojnë shumë nga trendet mesatare në nivel të Kosovës. Dendësia banimore ndryshon nga njëri vendbanim në tjetrin, duke arritur vlera më të larta në vendbanimet e ulëta përgjatë vijave kryesore rrugore, sidomos në qytetin e Drenasit si qendër komunale.

Bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2011, pra regjistrimi e fundit që është bërë në Kosovë, del se Drenasi ka gjithsejtë 58.531 banorë rezident, dhe afersisht 15.000 banorë jo rezident. Vendbanimi kryesor i Komunës është qyteti i Drenasit me 7210 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në vendet rurale të kësaj komune në gjithsej 42 vendbanime me 42938 banorë.

Sipas këtij regjistrimi, Komuna e Drenasit ka 14859 banesa (shtëpi) dhe 11787 ekonomi familjare. Të banuara janë 78.1% (9,206), kurse të pa banuara 21.9% (2,581).

Dy të tretat e teritorit të Komunës janë pjesë rrafshinore. Rrafshi i komunës e sidomos lugina e lumit "Drenica" dhe lumi Verboci është tokë me potenciale për zhvillim të agro-indistrisë duke pasë parasyshë edhe sistemin e ujitjes "Ibër-Lepenc" konsiderohet rrjeti kryesor hidrografik i saj.

Dendësia e popullsisë ne komunën e Drenas, është 212.22 banorë në km. katror.

Drenasi ka klimë kontinentale me të reshura mesatare gjatë vitit.

Nr	Subjekti		Të dhënat Statistikore		Shenime
1	Sipëfaqja		275.8 Km ²		212.22 Banor/km ²
2	Nr.Popullsi		58.531 banorë		Regjistrimi/2011
3	Nr.Popullsi jo-rezidente e pëafërt		15.000 banorë		25%
4	Vendbanimi kryesorë - Drenasi		7210 banorë		
5	Nr.Vendbanimeve		42 vendbanime me : 42938		
6	Dendësia Mesatare				212.22 km/2
7	Ekonomitë Familjare	Gjithsej:	11787	100%	
		Të Banuara	9,206	78.1 %	
		Të Pabanuara	2,581	21.9 %	
8	Dy të tretat e teritorit të Komunës		Pjesë rrafshinore		183.8 km/2
9	Rrafshi i Komunës e sidomos lugina përgjat lumit "Drenica"		Tokë me potenciale të mundëshme për zhvillimin e bujqësisë intenzive dhe zhvillim të agro-industrisë		

10	Lumi "Drenica", kanali i sistemit "Ibër-Lepenc" si dhe lumi Verboç	Konsiderohet të jenë rrjeti kryesor Hidrografik i Komunës	
----	--	---	--

Nr R.	Vendbanimi	Banorë			Nr.R	Vendbanimi	Banorë			Nr.	Vendbanimi	Banorë		
		Gj	M	F			GJ	M	F			GJ	M	F
1	Drenasi / U	6,143	3,021	3,122	16	Gjergjicë				31	Poklek i Ri			
2	Drenasi II / U				17	Glibobar	1,526	795	731	32	Polluzhë	1,017	506	511
3	Çikatovë e Re / U	2,026	1,016	1,010	18	Gllanasellë	1,591	789	802	33	Sankoc	1,437	749	688
4	Komoranlli/L.Re/U				19	Godanc	358	197	161	34	Shtrubullovë	1,102	547	555
5	L.Dëshmorë /Poklek Ri/U				20	Gradicë	842	430	412	35	Shtuticë	934	471	463
6	Lagja Feronikelit / U				21	Kishnarekë	1,504	787	717	36	Tërstenik	3,903	2,024	1,879
7	Abri e Epërme	1,776	915	861	22	Komoran	4,393	2,242	2,151	37	Tërdec	1,121	588	533
8	Arllat	3,134	1,569	1,565	23	Korroticë/L	1,240	634	606	38	Vasilevë	634	316	318
9	Balçë	2,307	1,202	1,105	24	Korroticë/U	972	507	465	39	Verboc	1,247	633	614
10	L.Bytyqëve				25	Krajkovë	1,181	601	580	40	Vuçak	369	180	189
11	Çikatovë Vjetër	1,261	625	636	26	Likoshan	1,261	625	636	41	ZabelEpërm	565	295	270
12	Damanek	706	346	360	27	Ulapushnik	3,433	1,718	1,715	42	Zabel i Ultë	1,077	539	538
13	Dobroshec	1,457	773	684	28	Negroc	1,540	771	769					
14	Fushticë / Ep	984	531	453	29	Nekoc	3,118	1,578	1,540					
15	Fushticë / P	1,066	535	531	30	Poklek i Vjetër	1,967	987	980					

Tabela 1. Të dhëna lidhur me vendbanimet e Komunës së Drenasit (sipas regjistrimit 2011, 35 vendregjistrime e gjithsej 42 vendbanime).

4.6 RASTET SOCIALE

Sipas Qendrës për Punë Sociale (QPS-së), në Drenas janë të regjistruar 1,308 familje në skema sociale që marrin ndihmë. Ky numër është një indikator i rëndësishëm për komisionin e krijuar për përpilimi e Programit Trevjeçar për të planifikuar numrin familjeve për tu ndihmuar në tre vitet e ardhshme me banim social.

Viti	Numri i familjeve
2022	1308

Tabela 2: Numri i familjeve përrfituese të asistencës sociale

SHTIMI NATYROR

Bazuar në raportet e DSHMS si dhe (Shërbimi i Ofiqarisë) pranë komunës së Drenosit, ka bërë të ditur se numri i lindjeve pra shtimi natyror në këtë komunë është në rënje.

Raportit të DSHMS nga Materniteti	viti	Nr i lindjeve në QKMF Drenas
	2003	747
	2004	648
	2005	543
	2006	525
	2022	10
Ne 6 mujorine e parë	2023	6

Sipas raporteve ne DSHMS të komunës së Drenosit numri i lindjeve ka rënjetë të madhe.

4.7 LËVIZJA E POPULLSISË

Lëvizja mekanike e popullsisë / Migrimet, Shpopullimi është mjaftë i theksuar edhe në komunën e Drenosit, sidomos në vendbanimet kodrinore – malore, si pasojë e kushteve jo të mira. Shpopullimi më i shfaqur është për shkak të koncentrimit më të madh të veprimtarive ekonomike, industriale dhe shumë veprimtarive tjera, dinamiken më të lartë të ardhjes e ka vetë qyteti i Drenosit. Përpos migrimit brenda Kosovës dhe në qendrën

komunale, mjaft i theksuar është edhe migrimi i popullatës jashtë Kosovës. Zhvillimi i ngadalshëm ekonomik, pamundësia për të siguruar punë, dhe persekutimet ndaj të rinjve deri në vitin 1999 kanë ndikuar që shumë të rinj të aftë për punë të detyrohen të migrojnë sidomos në vendet e Evropës Perëndimore, apo edhe më larg.

Drenasi / Përbërja etnike											
Viti 2011 / Etnia	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Turk	Serbë	Bosnjak	Egjiptian	Të Tjerë	Preferoj të mos përgjigjemi	
Rexhistrimi / 2011	58,531	29,728	28,803	58,445	5	2	14	2	22	3	

Tabela 2: Struktura Etnike - Komuna e Drenasit¹

4.8 MIGRIMI

Në raport me popullsinë rezidente, Drenasi ka popullsinë me përqindjen më të lartë, që ka shkuar jashtë vendit, me 25%. Dhe në qoftë se e llogarisim këtë përqindje në kuptimin më konkret, del që gati çdo i dyti banorë i Drenasit në krahasim me popullsinë rezidente, ka dalë jashtë Komunës së Drenasit. Emigrimi më i madh jashtë vendit, ka ndodhur gjatë viteve 1990-1998 para luftës në Kosovë. Pas vitit 1999/2000 ka vazduhar emigrimi në numër më të vogël si pasojë e kushteve shkatërruese të luftës rreth 90% djegëje të objekteve të banimit. Trendi i migrimit në Komunën e Drenas-it vazhdon edhe sot ku një numër i të rinjve po emigrojnë për shkak të kushteve ekonomike dhe për te siguruar një vend pune.

4.9 JETËGJATËSIA

Jetëgjatësia, është një prej treguesve të rëndësishëm sepse ka të bëjë me përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve dhe përkujdesjes më të mirë shëndetësore pastaj standardit të përmirësuar, ushqimit më adekuat etj. Nga këto të dhëna llogaritet treguesi i jetëgjatësisë. Jetëgjatesia në komunën e Drenasit mesatarisht është 69 (M)-71(F) vite, mesatarsisht e përafërt me jetëgjatësinë në Kosovë.

¹ Enti Statistikave të Kosovës / Rexhistrimi I Popullsisë 2011,

4.10 ARSIMI

Sistemi edukativ -mësimor-arsimor në komunën e Drenasit është i organizuar dhe funksionon në tri nivele të arsimit parauniversitar:

- Arsimi parashkollar;
- Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët,
- Arsimi i mesëm i lartë,

Në nivelin arsimor 0 (arsimi parashkollar), funksionon 1 (një) institucion publik parashkollar, me vijueshmëri të rregullt janë të përfshirë 135 fëmijë .

Në Komunën e Drenasit funksionojnë 2 (dy) institucione private parashkollore.

Procesi edukativ arsimor organizohet në 33 institucione arsimore të arsimit publik parauniversitar.

1 Institucion parashkollar publik,

30 institucione arsimore të arsimit fillor dhe mesëm të ulët (klasa përgatitore, klasa fillore dhe mesëm e ulët), numri i nxënësve 10393 në total.

2 institucione arsimore të arsimit mesëm të lartë, (klasa e dhjetë deri në dy mbëdhjetë), numri i nxënësve 2231 në total.

Numri i stafit arsimor : 756

Edukatore : 61,

Mësimdhënës/e: 695.

4.11 BANIMI

Banimi, si funksion kryesor është vendimtar për stabilitetin social, mjedis të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore në përgjithësi.

Banimi duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës, si aktiviteti themelor i vendbanimeve, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithëmbarshëm të shoqërisë dhe është komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomiko-social, përkatesisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi. Zona urbane e qytetit të Drenasit karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 212.22 banorë/ha.

Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale.

Shfrytëzimi i planifikuar i tokës - Me qëllim qe te sigurohet zhvillimi i ardhshëm i komunës, plani duhet te siguroje toke te mjaftueshme ndërtimore për banim, biznese dhe industri. Deri ne vitin 2028, parashihet nevoja për furnizim me 186 ha tokë ndërtimore. Me tutje përcaktohet qe qyteti i Gllogocit te dendësohet, te plotësohen hapësirat e pa zhvilluara brenda kufirit ndërtimor, për derisa zgjerimi ekzistues i ndërtimeve ne toka nen komasacion nuk do te lejohet. Projeksiuni i sipërfaqes se nevojshme te tokës për zhvillim te banimit është bazuar ne projekcionin e rritjes demografike duke u ndërlidhur me parametrat e dendësisë ekzistuese ne pole, nën-qendra dhe fshatrat tjera. Duhet te theksohet qe plani rekomandon rritjen e dendësisë përgjatë gjithë hapësirave te banuara, duke i respektuar kufijtë ndërtimor te vendbanimeve përmes plotësimit dhe dendësimit brenda kufijve.

Sa i përket mbulushmërisë së sipërfaqeve të tokave pjesën më të madhe e përbëjnë pyjet, tokat e punueshme dhe zonat tjera të sipërfaqeve bujqësore (Tabela 16 dhe figura 10).

Codi CLC18	Mbulesa tokësore	Sip Ha	%-sip
312	Pyjet Halore	63	0.23%
132	Zonë e Grumbullimit të Mbeturinave	44	0.16%
512	Trupat Ujorë	26	0.09%
133	Punishtet e Ndërtimit	54	0.20%
122	Rrjeti Rrugor dhe Hekurudhor	71	0.26%
112	Strukturë jo e vazhdueshme urbane	1244	4.50%
121	Njësit Industriale ose Komerciale	252	0.91%
131	Zonë e Nxjerrjes së Mineraleve	104	0.38%
211	Tokë e Punueshme pa sistem të ujites	5709	20.67%
231	Kullotat	841	3.04%
242	Struktura komplekse për kultivim	6026	21.81%
243	Tokë e nxënë kryesish nga kultura bujqësore, me sipërfaqe të konsiderueshme të vegjetacionit natyror	2332	8.44%
311	Pyjet gjetherënëse	9164	33.17%
321	Tokë livadhere natyrore (livadhe natyrore)	646	2.34%
324	Zona kalimtare pyje - shkurre	759	2.75%
333	Fusha të dobëta me vegjetacion	289	1.05%
Gjithsej		27624 Ha	100%

Faktorët themelor që ndikojnë në kërkesat për banim:

Rritja e popullsisë dhe të amvisërive si dhe ndryshimet në strukturat e tyre, si ngritja të fuqisë ekonomike të qytetit (Drenasit) kushtëzon nevojën e ndërtimit të një numri më të madh të banesave duke pasë pë bazë ndryshimi standardit dhe mënyrës jetësore. Nga ana tjetër vetëkushtëzohet nevoja për organizimin e hapësirës adekuate, e cila kërkohet nga planet urbane, avancimi i strukturës së hapësirës si dhe zgjedhja më e mirë e tereneve të parapara për ndërtim banesor.

- Zhvillimi ekonomiko-shoqëror i komunës dhe qytetit, gjë që i përcaktonte kornizat materiale të ndërtimit banesor;
- Rritja e strukturës së popullsisë dhe të amvisërive në qytet që do ti paraprinte rritjes natyrale të migrimit nga vendbanimet rurale;
- Vëllimi i strukturës të fondit ekzistues banesor i cili do të mbetej në shfrytëzim pas zbritjes së banesave të caktuara të cilat do të rrënohen për shkak të vjetërisë (amortizimit) si dhe rikonstruktimit të qytetit.

Qëllimet të cilat ishin paraparë të arrihen në përmirësimin e standardit të banimit deri në fund të periudhës për të cilën ishte punuar plani.

4.12 KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL

Në komunën e Drenasit gjatë gjithë vitit ka kërkesa për ndihmë për banim. Kërkесat bëhen përmes formularëve të DSHMS-së. Këto kërkesa shqyrtohen nga zyrtarë komunal, përkatësisht nga komisioni i cili caktohet nga drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Kërkесat kanë të bëjnë kryesisht me nevoja për renovime dhe riparime në shtëpi të vjetra apo të dëmtuara, kërkesë për gjera elementare, për shërim rehabilitim etj. Komisioni viziton këto familje dhe në bazë të kushteve dhe gjendjes faktike, përcakton kriteret e radhës së përparësisë në bazë të poenizimit.

Në vitin e kaluar (2022) në komunën e Drenasit janë paraqitur 64 kërkesa për banim, gjat verifikimit nga komisioni 7 nga këto kërkesa u evidentuan se nuk ishin destinuar për banim social, por paraqitësit e kërkesave nuk e kishin sqaruar siç duhet, megjithatë ata vetë pohuan se kanë bërë kërkesë për zgjidhje të banimit qoftë pagesë qiraje apo ndonjë formë tjetër. Ndërsa për renovim apo rindërtim të shtëpive kishim gjithësej 24 kërkesa. Meqenëse në data bazën qe kemi, ka disa mangësi një ndër to është poenizimi i të gjitha kategorive te invaliditetit. Gjithashtu gjendja faktike nuk përkon me gjendjen e prezantuar në dokumentacion, ku faktikisht ka raste kur familjet kanë bërë zgjidhje të banimit dhe ende nuk e lironjë banesën sociale të cilën e ka në shfrytëzim, ndërsa në tatimin në pronë e nuk ka të regjistruar, kështu që në mungesë të dokumentacionit (fakteve) për t'i vertetuar MMPH (ne të cilën bëhen ankesat), këto banesa mbesin banesa të pashfrytëzuara.

Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëfinancimi Nr.01-400-01-53531 dt.09/12/2020 në mes Komunës së Drenasit dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” janë ndërtuar 24 shtëpi.

5. ANALİZË EKONOMIKE

5.1 EKONOMIA

Politikat zhvillimore lokale në komunën e Gjilgocit luajnë rol thelbësor në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Bashkëpunimi i pushtetit lokal me bizneset e vogla dhe të mesme vlerësohet si çelës i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Zhvillimi ekonomik është planifikuar të zhvillohet duke u bazuar në resurset, kapacitetet dhe pozitën qendrore që ka komuna e Gjilgocit në Kosovë. Potencialet kryesore mbi të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i punësimit janë industria, toka bujqësore dhe bizneset (NVM-të)

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, zyra për regjistrim të Bizneseve, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022 janë të regjistrua 190 biznese të reja , krahasuar me vitin paraprak që ishin regjistruar 246 biznese ose shprehur në përqindje 33% më pak se në vitin e kaluar , të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë 200 punëtorë. Bizneset fillostarte brënda ditës paisën me çertifikatën e biznesit si dhe numrin unik të regjistrimit, pranë kësaj zyre jepen të gjitha konsulencat e nëvojshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa ma të volitshëm për regjistrimin dhe të gjitha ndryshimet e nëvojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

Tabela e klasifikimit të bizneseve sipas numrit të punëtorëve

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	78	41.05%
Të mesme	5 – 60 (Sh.p.k.)	112	58.94%
Të mëdha	60 - e më tepër	-	-
Gjithsejt:		190	100.00%

Vlenë të theksohet regjistrimi i bizneseve të tipit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizume kanë shënuar një rrije.

Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të mesme (58.94%)

Tabela e klasifikimeve te bizneseve sipas Sektorëve

Nr.	SEKTORËT E BIZNESEVE	Shpërndarja e bizneseve sipas sektorëve	Përqindja
1	Sektori F-NDERTIMTARIA	112	58.97%
2	Sektori I- AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	38	20 %
3	Sektori S - VEPRIMTARITË E TJERA SHËRBYESE	20	10.52%
4	Sektori G-TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	17	8.94%
5	Sektori M-VEPRIMTARITË PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	2	1.05
6	Sektori A-SEKTORI A -BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	1	0.52
7	Gjithësejtë....	190Biznese	100%

Nr	10 aktivitetet që shërbehen me se shumti nga bizneset	Shpërndarja e bizn. Sipas veprimtarive	Përqindja
1	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore-	41	21.57%
2	Aktivitetet shërbyese të pijeve.	31	16.31 %
3	Sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë.	20	10.52%
4	Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t	22	11.57%
5	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	15	7.9%

6	Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve	14	7.4%
7	Punime suvatimi	10	5.26%
8	Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave	12	6.31%
9	Punimet e kulmit (lçatisë)	15	7.9%
1	Restorantet dhe aktivitetet shërbuese	10	5.26%
0	lëvizëse të ushqimit		
Gjithësejtë.....		190 biznese	100 %

**Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën
01.01.2022– 31.12.2022**

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	78	41.06%
2	Ortakëri e përgjithshme		
3	Ortakëri e kufizuar		
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	112	58.94%
5	Shoqëri Aksionare		
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj		
7	Ndërmarrje publike		
8	Kooperativë bujqësore		
TOTALI		190	100%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2022– 31.12.2022 në Komunën e Drenasit, Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset me përgjithësi te kufizuara me 60.00% , SHPK-t edhe më tutje shënojnë një rritje konstante .

Gjatë periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithësejtë: 252 ndryshime të bizneseve ekzistuese ,në periudhën paraprake të vitit të kaluar bizneset që patën ndryshime ishte 121 biznese ose 48.00% me shumë se në periudhën e njejtë të vitit të kaluar dhe sipas muajve dukën kështu:

Nr.	Shërbimi/Lënda	Totali:
1	Çertifikata duplikat	19

2	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore.Kriter për dhënjen e banimit social duhet të jetë edhe vertetimi nga ARB-së. Në të cilën vertetohet që pala nuk ka biznes të regjistruar në Komunen e Gllogocit.	60
3	Vërtetima për persona fizik që ushtrojnë veprimtari biznesore.	1
4	Vërtetima për biznese për periudhen e para luftës.	3

5.2 BUJQËSIA

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Komunën e Drenasit është 27.560 hektar, ndërsa sipërfaqe e shfrytëzuar për bujqësi është 13.652.67 hektar apo në përqindje 49.53%

Tokë e punuhme ara.....	6103 ha, apo në përqindje 44.70%
Kopshte.....	83 ha, apo në përqindje 0.60%
Livadhe/kullota.....	7080 ha, apo në përqindje 51.80 %
Kulturë shumë vjeqare jo intensive - pemë.....	189.67 ha, apo në përqindje 1.37 %
Pemishte intensive.....	196 ha, apo në përqindje 1.43 %
Vreshta.....	1ha, apo në përqindje 0.1 %

Gjithsej sipërfaqe: 13.652.67 ha apo në përqindje 100%

Tokë bujqesore e pa perdonur – Djerrinë:.....1.651.66 ha apo në përqindje 5.99%

Pyje Publike..... 4.315.00 ha

Pyje Private..... 7.040.00 ha

Gjithsej sipërfaqe: 11.355.00 ha ose në përqindje 41.21%

Toke jo Bujqësore.....769.28 ha apo në përqindje 2,79%

Lumenjët.....131.39 ha apo në përqindje 0.48 %

Gjithsej sipërfaqe: 13907.33ha apo në përqidje 50.47 %


